Komunikata

28/04/2026

Raporti I Ngjarjeve, 28 Prill 2026

Lezhë

Vijojnë intensivisht veprimet hetimore për gjetjen dhe sekuestrimin e provave, me qëllim dokumentimin ligjor të ngjarjes së ndodhur më datë 26.04.2026, në fshatin Baldren.

Njësitet e kontrollit intensive për kapjen e autorëve të dyshuar të shpallur në kërkim dhe të shtetasve të njerë të perfshirë në këtë ngjarje.

Gjendet dhe sekuestrohet automjeti tip "Volkswagen Polo", nga i cili autorët qëlluan me armë zjarri, në drejtim të automjetit me të cilin lëvizninin shtetasit K. M. dhe G. M.

Gjithashtu, gjenden dhe sekuestrohen veshjet e autorëve, në momentin e kryerjes së krimit, si dhe një palë targa.

Shpallet në kërkim një shtetas dhe procedohet penalisht babai i tij.

Në vijim të veprimeve intensive hetimore dhe operacionale, që janë kryer dhe vijojnë të kryhen nga grupi i posaçëm hetimor, për sigurimin e provave, me qëllim dokumentimin e plotë ligjor të ngjarjes së ndodhur më datë 26.04.2026, në fshatin Baldren, Lezhë, ku u vranë me armë zjarri, shtetasit K. M. dhe G. M., bashkëshortë, mesdhëm e sotme, në fshatin Torovicë, në banesën e shtetasit B. K., shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar automjetin tip "Volkswagen Polo", pa targa, të përdorur nga autorët.

Gjatë kontrollit në brendësi të automjetit, grupi hetimor gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale, 2 gëzhoja model 56, dhe nga këqyrja, rezultoi se automjeti ka të thyer xhamin e pasmë dhe trekëndëshat anësorë të dyerve.

Gjithashtu, në oborrin e banesës së shtetasit B. K., u gjet një automjet identik me automjetin e paré, në pronësi të shtetasit B. K., por me targa.

Më tej, gjatë kontrollit, u gjetën dhe veshjet e përdorura nga autorët, në momentin e kryerjes së krimit.

Nga veprimet hetimore rezultoi se shtetasi F. M. ka marrë automjetin tip "Volkswagen Polo" (të cilin motra e tij e kishte marrë me qira, në Rinas), i ka hequr targat dhe në bashkëpunim me njërin nga 2 shtetasit e shpallur në kërkim, e kanë përdorur për ti prerë mugën dhe për të qëlluar në drejtim të automjetit me të cilin lëvizninin shtetasit K. M. dhe G. M.. Pas krimit, e ka çuar automjetin, në banesën e shtetasit B. K., dhe e ka fshehur duke e mbuluar me bar, me qëllim humbjen e gjurmëve, gjithashtu me pretendimin se automjeti e tij, shtetasi B. K. e kishte identik dhe të rregullt.

Në vijim të veprimeve, u shpall në kërkim shtetasi B. K., 22 vjeç, banues në fshatin Torovicë, për veprat penale "Vrasja në nethana të tjera cilësuese" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

Gjithashtu, u referuan materialet në Prokurori, për babanë e 22-vjeçarit, shtetasin N. K., 79 vjeç, banues në fshatin Torovicë, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

Njësitet e kontrollit intensive dhe operacionale kërkimet në terren, për lokalizimin dhe kapjen e autorëve, si dhe të shtetasit të shpallur në kërkim mesdhëm e sotme.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Lezhës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Gjirokastër shpallën në kërkim shtetasin J. S., 46 vjeç banues në Berat, pasi ka marrë me qira një automjet, në Gjirokastër, më datë 16.04.2026, dhe nuk e ka kthyer. Punohet për kapjen e tij.

Gjithashtu, referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për:
-ky shtetas 16 vjeç, banues në Gjirokastër, pasi dyshohet se kanë vjedhur produkte në një market;
-shtetasin Th. LI., banues në fshatin Tërbuq, pasi dyshohet se ka dëmtuar vreshtin e një 52-vjeçari, duke futur bagëtitë aty.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Stacionit të Policisë Memaliaj referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin M. Sh., 64 vjeç, banues në fshatin Vasjar, pasi dyshohet se i ka dëmtuar automjetin një 68-vjeçari, për motive të dobëta.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve arrestuan shtetasit:
-D. K., 23 vjeç, pasi shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja" i gjetën me vete, sasi të lëndës së dyshuar narkotike Cannabis Sativa, e cila u sekuestrua me cilësinë e provës materiale. 23-vjeçari u kap gjatë tentativës për t'u larguar, pas kundërshtimit të punonjësve të Policisë. Nga verifikimet e mëtejshme rezultoi se ky shtetas kishte thyer masën e sigurisë "Arrest në shtëpi";
-F. B., 24 vjeç, pasi shërbimet e Komisariatit të Policisë Rrugore i gjetën me vete, sasi të lëndës së dyshuar narkotike Cannabis Sativa, e cila u sekuestrua me cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin E. B., pasi dyshohet se ka mashtruar shtetasin K. H., në lidhje me shitjen e disa mallrave, veprim për të cilin shtetasi K. H. pretendon se kishin marrëveshje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. A., pasi dyshohet se ka goditur me grushte, shtetasin F. B..

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-E. Gj., pasi dyshohet se ka goditur me shpullë, bashkëjetuesen, dhe i ka dëmtuar banesën;
-V. B., pasi dyshohet se ka kanosur njëpërmjet thirrjeve/mesazheve telefonike, shtetasin K. Z..

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3 shpallën në kërkim shtetasin Xh. Z., pasi dyshohet se ka vjedhur shiron ditore dhe 1 celular, në subjektin ku punonte. Punohet për kapjen e këtij shtetasi.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4:
-ndaluan shtetasin I. L., 50 vjeç, pasi është dënuar me 2 vjet e 3 muaj burgim, për veprën penale "Vjedhja me dhunë";
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin K. H., pasi dyshohet se njëpërmjet mashtrimit, i ka marrë automjetin, shtetasves E. L.;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin S. K., pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka kanosur shtetasin E. M.;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin S. C., pasi ka tentuar të vjedhë në një autobus. Gjithashtu, ky shtetas ka kanosur një pasagjer në autobus, i cili ka konstatuar veprimet e tij. Nga kontrolli, shtetasit iß procedoar iu gjet një mjet prerës (thikë), i cili u sekuestrua me cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5 arrestuan shtetasin S. A., 40 vjeç, pasi dyshohet se ka përndjekur shtetasin E. P.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin Sh. G., pasi dyshohet se për fjogari të subjektit në të cilin ky shtetas është drejtues teknik, janë hedhur inerte në një rrugë të fshatit Doréz, në kundërshtim me ligjin.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 7 arrestuan shtetasin A. I., 18 vjeç, pasi dyshohet se si pasojë e zjarrit që na ndeçur për të djegur barishte dhe ferra, në fshatin Muçaj, janë djegur disa pemë/dru fruturë.

Specialistët e qarkullimit rrugor vunë në pranga shtetasit:
-E. R, pasi u kap duke drejtuar automjet, pa leje drejtimi;
-F. M., 37 vjeç, pasi është dënuar me 2 muaj burgim, për veprën penale "Drejtimi i automjetevE në mënyrë të parregullt";
-M. D., 31 vjeç, sepse pas ndalimit për verifikime, të automjetit që drejtonte, i ka paraqitur punonjësve të Policisë, lejen e drejtimit të një shtetasi tjetër. Nga verifikimet rezultoi se 31-vjeçari i ishte hequr leja e drejtimit.

Më datë 27.04.2026, kallëzuan shtetasit:
-B. N., se i kishin ndërhyrë në mënyrë të paligjshme, në faqen në internet, që administron;
-N. M., se i kishin vjedhur motorsipërin.
Punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve të të dyja rasteve.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Sarandë arrestuan në flagrancë shtetasin E. M., 39 vjeç, banues në Sarandë, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj babait të tij.

Specialistët e Seksionit të Trafikut Urban dhe Interurban të DVP Vlorë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-E. C, 31 vjeçe, banuese në Kamëz, pasi duke drejtuar automjetin, pa leje drejtimi, në aksin rrugor "Vlorë-Orikum", ka përplasur automjetin me drejtues shtetasin A. S. Nga aksidenti janë shkaktuar vetëm dëme materiale;
-P. V., 71 vjeç, banues në Delvinë, pasi në rugën "Skënderbeu", Sarandë, duke drejtuar automjetin, ka përplasur motorsipërin me drejtues shtetasin B. N., 59 vjeç, banues në Sarandë. Si pasojë është dëmtuar shtetasi B. N., i cili po merr mjekim në Spitalin e Traumës.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Vlorë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-E. H., 38 vjeç, banues në Vlorë, pasi dyshohet se në orët e para të mëngjesit, në lagjen "Isa Boletini", ka tentuar të vjedhë në një dyqan që i ka thyer xhamin e derës;
-Th. T., 54 vjeç, pasi janë konstatuar duke kryer punime ndërtimi, pa leje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Sarandë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-A. B., 24 vjeç dhe Xh. D., 20 vjeç, banues në Sarandë, pasi shtetasi A. B. dyshohet se ka goditur me grusht Xh. D., për motive të dobëta, ndërsa ky i fundit dyshohet se e ka kanosur shtetasin A. B., njëpërmjet celularit;
-E. D., 27 vjeç, banues në Sarandë, pasi ka kallëzuar shtetasi D. C se ai e ka goditur me grushte, për motive të dobëta.

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Himarë referuan materialet në Prokurori, pasi në fshatin Vuno, në vendin e quajtur "Gjiri i Akuariumit", 2 shtetasa që dyshohet se po pesëkonin janë larguar sapo kanë vënë re shërbimet e Policisë. Në vendin ku ishin këta shtetas, shërbimet e Policisë gjetën një sasi lëndë shpërthyese që dyshohet se përdorej për peshkim. Punohet për identifikimin dhe kapjen e këtyre 2 shtetasve.

Materialet procedurale iu referuan prokurorive kompetente, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan

Në vijim të informacionit paraprak të dhënë dje, për aksidentin në aksin rrugor "Elbasan-Librazhd", bëjmë me dije se specialistët e qarkullimit rrugor arrestuan në flagrancë për veprën penale "Shkelja e regullave të qarkullimit rrugor", me pasojë vdekjen, shtetasin V. M., 26 vjeç, banues në Pogradec, pasi automjeti që ai drejtonte është përplasur me një automjet me targa kineze, si pasojë ka humbur jetën drejtuesi i këtij të fundit.

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve ekzekutuan masën e sigurisë "Arrest në burg", për shtetasin R. A., 25 vjeç, të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Elbasan referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin J. K., 64 vjeç, për veprën penale "Ndërtimi i paligjshëm".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Gramsh referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për një 14-vjeçar, pasi dyshohet se ka vjedhur në një dyqan, në lagjen "Xhile Liçi".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Librazhd referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin S. H., pasi ka dëmtuar me send të forté, automjetin e një 48-vjeçari, për motive të dobëta.
Specialistët e qarkullimit rrugor referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-R. C., 33 vjeç, pasi në mugën "Qemal Stafa", me automjetin që drejtonte, ka aksidentuar lehtë shtetasen M. H., 38 vjeçe, këmbësore;
-P. C., 67 vjeç, pasi motorsipëri që ai drejtonte, pa leje drejtimi, është përplasur me automjetin me drejtuese shtetasen B. S., 43 vjeç. Si pasojë është dëmtuar shtetasi P. C., i cili është jashtë rrezikut për jetën.

-Më datë 27.04.2026, ka kallëzuar shtetasi Sh. E., 57 vjeç, se më datë 26.04.2026, është larguar nga banesa vajza e tij, shtetasja M. E., 25 vjeçe. Po punohet për gjetjen e saj.

-Më datë 27.04.2026 në Spitalin Rajonal Elbasan, është dërguar për mjekim shtetasi egjiptian M. M., 24 vjeç, i cili dyshohet se aksidentalisht ka mëshqitur në ambientin e punës. Ai mori mjekim dhe u largua në banesë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Durrës

Specialistët e qarkullimit rrugor arrestuan në flagrancë shtetasin A. M., 63 vjeç, banues në Durrës, pasi dje, në lagjen nr. 15, duke drejtuar automjetin, ka përplasur motorsipërin me drejtues shtetasin R. D. Si pasojë e aksidentit janë dëmtuar shtetasi R. D. dhe një shtetas që udhëtonte me të, të cilët po marrin ndihmë mjekësore në spital.

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve arrestuan në flagrancë shtetasin A. Gj., 26 vjeç, banues në Durrës, pasi gjatë kontrollit në automjet, iu gjetën një sasi e vogël lëndë e dyshuar narkotike Cannabis Sativa dhe një përforcues grushti, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Durrës:
-ndaluan shtetasin në kërkim R. E., 29 vjeç, banues në Durrës, pasi Gjykata e Durrësit, më datë 11.03.2026, e ka dënuar me burgim, për veprën penale "Vjedhja". Nga dënimi kanë mbetur për të kryer 3 muaj e 24 ditë burgim;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. T., 25 vjeç, banues në Durrës, për veprën penale "Prishja e qetësisë publike";
Gjithashtu, këtu specialistët referuan materialet në Prokurori, pasi kanë kallëzuar shtetasit:
-K. K., 22 vjeç, banues në fshatin Bisht Kamëz, Durrës, se në fshatin Sektor Rinia, i kanë vjedhur targat e automjetit.
Punohet për identifikimin e kapjen e autorit/ve;
-I. L., se djali i tij, shtetasi E. L., 28 vjeç, është larguar nga banesa dhe prej 10 ditësh ka humbur kontaktet me të.
Punohet për gjetjen e tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Stacionit të Policisë Manëz referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin D. Gj., 32 vjeç, pasi është konstatuar duke kryer punime ndërtimi, pa leje, në kikalin e tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kavajë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin I. Xh., 36 vjeç, banues në Tiranë, pasi dyshohet se ka shqetësuar një 31-vjeçare, njëpërmjet thirjeve telefonike.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

Durrës/ Informacion paraprak
Në lagjen nr. 8, është gjetur në banesë, pa shenja jete, shtetasi P. Rr., 76 vjeç. Nga këqyrja e trupit nuk janë konstatuar shenja dhune apo dëmtime të tjera. Nga veprimet e para hetimore dyshohet se ai ka humbur jetë për shkaqe natyrale.
Grupi hetimor po punon për dokumentimin e rethanave të rastit.

DVP Fier

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent